



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 58, Datë 16.02.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË DETYRË
NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 187, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Ilir Toska, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR